EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6713
E premte, 23 shtator 2022
çmimi 0.40 €

## Osmani, Stoltenbergut: Anëtarësimi i Kosovës në NATO dhe BE i kontribuon paqes në rajon

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS DEBATON PËR GREVËN NË ARSIM FAQE 4-5

# OPOZITA KËRKON ZGJIDHJE PËR GREVËN NË ARSIM, PUSHTETI NUK LËVIZ VENDI

Pushteti dhe opozita janë përplasur verbalisht në Kuvendin e Kosovës për grevën në arsim. Deputetët e opozitës kanë kërkuar nga qeveria të ofrojë zgjidhje për t'i dhënë fund grevës në arsim. Sipas tyre, është obligim i qeverisë t'i kthejë fëmijët në shkolla. Ndërsa kryeministri Albin Kurti dhe ministrja e Arsimit kanë thënë se janë adresuar të gjitha "kërkesat e arsyeshme" të sindikalistëve. Kurti ka thënë se e pranon arsyeshmërinë e Këshillit Grevist se janë shtrenjtuar çmimet e shportës ushqimore dhe ka inflacion, por mënyra sesi zgjidhen këto, sipas tij, nuk janë përmes kërkesave të tyre dhe ai nuk mund t'i plotësojë ato



# NDËRRON JETË PËRFAQËSUESI I LËVIZJES STUDENTORE I '97-S, ALI AHMETI



Ka ndërruar jetë përfaqësuesi i Lëvizjes Studentore i '97-s, Ali Ahmeti. Lajmi për vdekjen e tij i ka prekur të gjithë, veçanërisht liderët e lëvizjes studentore, Muhamet Mavraj, Bujar Dugolli, Driton Lajçi dhe miqtë e tij. Ata kanë thënë se Aliu ka qenë i pathyeshëm dhe organizator i protestave studentore. Po ashtu, ata kanë vlerësuar se Aliu ka qenë edhe luftëtar i shqunar i UÇK-së. Ali Ahmetit do t'i jepet lamtumira e fundit më 24 shtator

## AKTUALE



PËRKUJTOHEN FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI: ATA JANË THEMELET E KOSOVËS SË LIRË! F. 7

HAXHIU TAKOHET ME TRENDAFILOVËN, DISKUTOJNË PËR PUNËN E GJYKATËS SPECIALE F. 6

PROTESTOJNË SINDIKALISTËT E MPJD-SË, KËRKOJNË TË KTHEHET RENDI KUSHTETUES NË SHËRBIMIN E JASHTËM F. 5

## EKONOMI



BIZNESMENI SHKËLQIM DEVOLLI TAKON ISH-SEKRETARIN AMERIKAN TË SHTETIT, JOHN KERRY F. 8

PROCEDOHET PËR MENDIM NË QEVERI PROJEKTLIGJI PËR TRUSTIN F. 8

## SPORT



FAZLIJI DHE EMËRLLAHU: KËRKOJMË FITORE NDAJ IRLANDËS SË VERIUT F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

## Rusët nxitojnë të ikin pas urdhrit për mobilizim ushtarak

**Moskë, 22 shtator** - Shumë rusë kanë rezervuar me nguti bileta njëdrejtimëshe për t'u larguar nga Rusia pasi presidenti i shtetit, Vladimir Putin, ka shpallur mobilizim të pjesshëm të rezervistëve ushtarakë për luftën në Ukrainë.
Ministri rus i Mbrojtjes, Sergei Shoigu, ka thënë në një intervistë televizive se do të mobilizohen 300 000 rezervistë me përvojë përkatëse ushtarake.
Çmimet e biletave janë rritur menjëherë, pasi ka shqetësime se kufijtë e Rusisë mund të mbyllen shpejt, po qe se Putini mund të shpallë mobilizim të plotë.
Një numër i madh i rusëve veçse e kanë lëshuar shtetin prej kur Putini ka urdhëruar ushtrinë që ta pushtojë Ukrainën gati shtatë muaj më parë.
"Air Serbia", kompania e vetme evropiane – përveç "Turkish Airlines" që realizon fluturime në Rusi, pavarësisht embargos së vënë nga Bashkimi Evropian, ka shitur biletat shpejt në destinacionin Moskë - Beograd. Biletat për fluturimet prej Moskës drejt Stambollit dhe Dubait janë shitur në deri 9 200 euro.
Një grup me bazë në Beograd, i quajtur "Rusët, bjellorusët, ukrainasit dhe serbët të bashkuar kundër luftës", ka bërë me dije se nuk ka më bileta për fluturimet nga Rusia në Beograd deri në mesin e muajit tetor.
Edhe biletat për fluturimet drejt Turqisë, Gjeorgjisë dhe Armenisë, janë shitur po ashtu. Rusët mund të hyjnë në Serbi pa



viza. Beogradi nuk u është bashkuar sanksioneve të Perëndimit kundër Rusisë për luftën e nisur në Ukrainë. Vendet aleate sikurse Bjellorusia dhe Kina nuk kanë vënë, po ashtu, sanksione ndaj Rusisë.

# Ukraina dhe Rusia bëjnë shkëmbimin më të madh të të burgosurve

**Kiev, 22 shtator** - Ukraina ka bërë me dije se në kuadër të shkëmbimit të të burgosurve ka rikthyer 215 ushtarë, derisa i ka dorëzuar Rusisë 55 të tillë, përfshirë politikanin pro-Moskës, Viktor Medvedchuk.
Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka njoftuar për këtë shkëmbim të të burgosurve para kombit më 21 shtator.
Zelensky ka thënë se pesë komandantë ushtarakë, duke përfshirë liderët e mbrojtjes në fabrikën e çelikut Azovstal, janë dërguar në Turqi në kuadër të një operacioni që është përgatitur paraprakisht dhe për të cilin është pajtuar presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan.
Të liruarit nga burgu do të qëndrojnë në Turqi "në siguri totale dhe kushte të rehatshme" deri në fund të luftës, ka thënë Zelensky. Në mesin e 55 të burgosurve të dërguar në Rusi ka qenë edhe Viktor Medvedchuk, ish-ligjvënës ukrainas dhe aleat i presidentit rus Vladimir Putin, ka thënë Zelensky. Medvedchuk është mbajtur nën arrest shtëpiak prej majit të vitit 2021, nën akuzat për tradhti. Zelensky edhe më herët ka propozuar këmbimin e tij me të burgosurit e luftës që janë mbajtur nga forcat ruse.
Ky është shkëmbimi më i madh i të burgosurve prej nisjes së luftës në fund të muajt shkurt. "Ne kemi arritur të lirojmë 215 persona", ka thënë shefi i kabinetit të Zelenskyt, Andriy Yermak. Sipas tij, 108 kanë



qenë luftëtarë në regjimentin e Azovit.
Yermak ka thënë, po ashtu, se shkëmbimi i të burgosurve ka ndodhur në lokacione të ndryshme. Zelensky ka thënë se në mesin e ushtarëve të rikthyer janë edhe pesë britanikë dhe dy amerikanë, të cilët janë transferuar nga Rusia në Arabinë Saudite në kuadër të shkëmbimit. Të burgosurit e luftës janë shkëmbyer në ditën kur presidenti rus, Vladimir Putin, ka shpallur mobilizim të pjesshëm.
Ministri rus i Mbrojtjes, Sergei Shoigu, ka thënë, në një intervistë televizive, se do të mobilizohen 300 000 rezervistë me përvojë përkatëse ushtarake.
Presidenti rus Vladimir Putin ka urdhëruar pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.
Ai e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.
Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

# OKB-ja: Mbi 1 milion persona në botë rrezikojnë të vuajnë nga uria

**Nju-Jork, 22 shtator** - Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) ka paralajmëruar për krizën ushqimore e cila prek shumë rajone të botës në zhvillim. Rreth një milion njerëz në mbarë botën janë të rrezikuar nga uria dhe janë në rrezik të vdekjes në muajt e ardhshëm nëse nuk marrin ndihmë humanitare, një numër rekord kryesisht për shkak të thatësirës në Bririn e Afrikës, ka paralajmëruar OKB-ja. Këto vlerësime janë publikuar në një raport ditën e djeshme nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e OKB-së (FAO) dhe Programi Botëror i Ushqimit



(WFP). Raporti paraqet situatën e 19 vendeve që konsiderohen si "pikat e nxehta" në të gjithë botën dhe gjashtë prej të cilave janë vënë në "gatishmërinë më të lartë" nga OKB-ja: Afganistani, Etiopia, Nigeria, Sudani i Jugut, Somalia dhe Jemeni.
Në këto gjashtë vende, 970 000 njerëz pritet t'i plotësojnë kriteret për fazën e "katastrofës", niveli më i lartë (5) në renditjen e pasigurisë ushqimore, deri në janar 2023. Kjo do të thotë se "uria dhe vdekja janë një realitet i përditshëm" dhe se kjo është një situatë në të cilën "mund të regjistrohen shkallë ekstreme të vdekshmërisë dhe kequshqyerjes nëse nuk merren masa të menjëhershme".
Ky numër është dhjetë herë më i lartë se gjashtë vjet më parë për shkak të ndikimit të konfliktit, ndryshimeve klimatike dhe paqëndrueshmërisë ekonomike të përkeqësuar nga pandemia Covid-19 dhe ndikimi i krizës në Ukrainë.
Presidenti amerikan Joe Biden ka njoftuar një paketë ndihme prej 2.9 miliardë dollarësh për t'u përballuar me urinë. Udhëheqësit botërorë kanë bërë thirrje për përpjekje të dyfishuara për ta menaxhuar pasigurinë ushqimore në rritje në botë.
Guatemala, Hondurasi dhe Malavi janë në listën e OKB-së si vendet më të rrezikuara.
Agjencia, gjithashtu, është e shqetësuar për përkeqësimin e situatës në Republikën Demokratike të Kongos, Haiti, Kenia dhe Siri.
"Numri i njerëzve që po përballen me pasiguri akute ushqimore në mbarë botën pritet të rritet me një ritëm marramendës", ka paralajmëruar David Beazley, drejtor ekzekutiv i WFP.
Në Bririn e Afrikës deri në 26 milionë njerëz pritet të jenë në një situatë të tillë. Thatësira që ka prekur rajonin ka shkatërruar të korrat, ka zhdukur bagëtinë dhe ka detyruar mijëra njerëz të largohen nga shtëpitë e tyre.
"Në mungesë të një përgjigjeje adekuate humanitare, analistët parashikojnë se deri në katër fëmijë ose dy të rritur për 10 000 njerëz do të vdesin çdo ditë në Somali deri në dhjetor", ka njoftuar OKB-ja.

## Truss: Do të vazhdojmë të ofrojmë ndihmë ushtarake për Ukrainën deri në fitoren e saj kundër Rusisë

**Nju-Jork, 22 shtator** - Mbretëria e Bashkuar do të vazhdojë të ofrojë ndihmë ushtarake për Ukrainën deri në fitoren e saj kundër Rusisë ka thënë kryeministrja britanike, Liz Truss, në fjalimin e saj në Asamblenë e Përgjithshme të 77-të të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
"Në këtë moment kritik të luftës, unë zotoj se do të ruajmë ose rrisim mbështetjen tonë ushtarake për Ukrainën për aq kohë sa të duhet. Ne nuk do të ndalemi derisa Ukraina të triumfojë", ka thënë Truss.
Më herët, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka kërkuar që Rusia të ndëshkohet për krimet, të cilën presidenti amerikan, Joe Biden, e ka akuzuar për "shkelje" të parimeve themelore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
Truss ka thënë se presidenti rus Vladimir Putin, i cili ka njoftuar mobilizimin e qindra mijëra rezervistëve, "po përpiqej ta justifikonte dështimin e tij katastrofik" në Ukrainë.
Por kjo "nuk do të funksionojë", ka thënë Truss, duke shtuar se aleanca ndërkombëtare është e fortë dhe Ukraina është e fortë.
Për Liz Truss "ukrainasit nuk po mbrojnë vetëm vendin e tyre, ata po mbrojnë vlerat tona dhe sigurinë e të gjithë botës" dhe "kjo është arsyeja pse ne duhet të veprojmë".
Kryeministrja është zotuar se "deri në vitin 2030 Mbretëria e Bashkuar do të shpenzojë 3 për qind të PBB-së së saj për



mbrojtjen, duke ruajtur pozitën e saj udhëheqëse si një faktor sigurie në Evropë".

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

## Amerika i "bashkon" deputetët e pushtetit dhe të opozitës



Uashington, 22 shtator (ER) - Disa deputetë të Kuvendit të Kosovës po qëndrojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) në kuadër të një programi të Departamentit të Shtetit.
Blerta Deliu, deputete e PDK-së, ka publikuar një fotografi të takimit të tyre dhe ka shkruar: "Përherë falënderuese ndaj shtetit amerikan për angazhimin në mbështetje të ndërtimit dhe zhvillimit të institucioneve demokratike në Kosovë".

# Ndërron jetë përfaqësuesi i Lëvizjes Studentore '97, Ali Ahmeti



Ka ndërruar jetë përfaqësuesi i Lëvizjes Studentore '97, Ali Ahmeti. Lajmi për vdekjen e tij i ka prekur të gjithë, veçanërisht liderët e Lëvizjes Studentore '97, Muhamet Mavraj, Bujar Dugolli, Driton Lajçi dhe miqtë e tij. Ata kanë thënë se Aliu ka qenë i pathyeshëm dhe organizator i protestave studentore. Po ashtu, ata kanë vlerësuar se Aliu ka qenë edhe luftëtar i shquar i UÇK-së. Ali Ahmetit do t'i jepet lamtumira e fundit më 24 shtator

"Epoka e re"

Prishtinë, 22 shtator - Ka ndërruar jetë, në moshë të re, Ali Ahmeti, përfaqësues i Lëvizjes Studentore '97 për Mitrovicë. Njoftimin për vdekjen e Ali Ahmetit e kanë dhënë familjarët e tij, miqtë dhe bashkëpunëtorët e Ali Ahmetit.
Lajmi për vdekjen e Ahmeti i ka prekur të gjithë miqtë e tij, sidomos liderët e Lëvizjes Studentore të '97-s. Lideri i Lëvizjes Studentore të '97-s, Muhamet Mavraj, ka thënë se Ahmeti ka qenë person entuziast dhe luftëtar i lirisë. Mavraj ka thënë se emri i Aliut meriton respekt të thellë jo vetëm nga qytetarët e Mitrovicës. "Frymën ma këpute, Ali Ahmeti. Të prisja për kafe në Prishtinë, siç e lamë. Aliu ishte veprimtar studentor i 97-s në Mitrovicë, shumë entuziast, dhe luftëtar i lirisë. Shumë shok! Fort shok! Sivjet u përball me dinjitet e optimizëm epik me sëmundjen, por iu bënë dy dhe e paskan mposhtur në Gjermani. Ngushëllimet më të sinqerta familjes së ngushtë, bashkëshortes e fëmijëve, vëllazërisë e motërisë, farefisit, mbarë shoqërisë dhe mbarë bashkëveprimtarëve dhe bashkëluftëtarëve! Emri i Aliut meriton respekt të thellë jo vetëm nga qyteti i Mitrovicës! E pifshim në parajsë atë kafe që na mbeti peng, i dashur Ali!", ka shkruar Muhamet Mavraj në "Facebook".
Ndërsa lideri tjetër i Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, ka thënë se Ali Ahmeti ka qenë njeri i pathyeshëm dhe organizator i shquar i protestave studentore. "Sot morëm lajmin për ndarjen nga jeta të shokut të çmuar e të dashur, Ali Ahmeti. Aliun e kam njohur që nga koha e Lëvizjes Studentore '97 dhe ashtu do ta kujtoj përherë, si një burrë i vendosur, si shok besnik, patriot e atdhetar i dalluar. Ai ishte i pathyeshëm, si organizator i demonstratave studentore më 1 tetor 1997 në Mitrovicë, të cilat i organizonte atje. Ai ishte shembull i një aktivisti të madh e të përkushtuar në punë e me sjellje shembullore për të gjithë ne. Ndarja nga jeta në moshë kaq të re e Aliut është humbje për familjen e nderuar Ahmeti, që ka dhënë kontribut të madh në luftën çlirimtare, është humbje për bashkëpunëtorët e tij, por edhe për të gjithë ne që në etapa të caktuara kohore e njohëm dhe mbajtëm të pashuar respektin për të. I përjetshëm do të jetë kujtimi për shokun tonë Ali Ahmeti!", ka shkruar Bujar Dugolli në "Facebook".
Edhe Driton Lajçi, lider i Lëvizjes Studentore të '97-s, ka thënë se Ali Ahmeti do t'i mungojë të gjithë shoqërisë. "Do na të mungojë Ali Ahmeti. Ngushëllime Muhamet dhe gjithë shoqërisë!", ka komentuar Lajçi në "Facebook".
Për vdekjen e Ali Ahmetit ka reaguar edhe drejtoresha për Kulturë në KOMUNËN e Mitrovicës, Valdete Idrizi. "Miq të dashur, më shumë dhimbje po e ndaj me ju një lajm të kobshëm. Miku ynë, Ali Ahmeti, na la sot, pas një beteje me sëmundjen e rëndë që e kishte kapluar muaj më parë. Aliu ishte i buzëqeshur, i qetë e me plot shpresë se do ta tejkalonte këtë sfidë të rëndë. Folëm gjatë atë ditë, për jetën, familjen, për të ardhmen, pa e ditur se do të ishte biseda jonë e fundit. Çfarë humbje e madhe për familjen, për miqtë, për qytetin e tërë vendin. Ishte njeri i mirë, profesionist i zoti, qytetar dhe familjar shembullor. Ishte aktivist e luftëtar në kohët më të vështira, edhe në ato më të mira. Unë e kisha mik për më shumë se tri dekada. E kisha vëlla. Ngushëllime familjes së gjerë Ahmeti e Haliti, miqve dhe të gjithëve! Shpirti i tij pushoftë i qetë në paqe!", ka shkruar Idrizi në "Facebook".
Po për vdekjen e Aliut ka reaguar edhe miku i tij, Muhamet Selmani. Ai ka thënë se do t'i mungojnë bisedat dhe buzëqeshjet me Aliun. "Do të na mungojnë bisedat, buzëqeshjet e inspirimi yt, Ali", ka shkruar Selmani në "Facebook".
Ali Ahmeti do të varrohet më 24 shtator në varrezat e dëshmorëve në Shipol të Mitrovicës në orën 16:00.

## Osmani, Stoltenbergut: Anëtarësimi i Kosovës në NATO dhe BE i kontribuon paqes në rajon

Nju-Jork, 22 shtator (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, gjatë vizitës në Nju-Jork, kanë takuar sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg. Me këtë rast, Osmani ka thënë se Kosova është mirënjohëse për mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s për ruajtjen e stabilitetit dhe paqes. Sipas presidentes Osmani, qëllimi strategjik i Kosovës mbetet anëtarësimi në komunitetin euroatlantik.
Presidentja Osmani në takim me shefin e NATO-s ka thënë se anëtarësimi në Bashkimin Evropian (BE) dhe NATO do të kontribuojë për rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe e ka cilësuar anëtarësimin në këtë organizatë, prioritet shtetëror të Kosovës si një parakusht për sigurimin e paqes në rajon, edhe për promovimin dhe mbrojtjen e vlerave të përbashkëta.



KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS DEBATON PËR GREVËN NË ARSIM

# Opozita kërkon zgjidhje për grevën në arsim, pushteti nuk lëviz vendi

Pushteti dhe opozita janë përplasur verbalisht në Kuvendin e Kosovës për grevën në arsim. Deputetët e opozitës kanë kërkuar nga qeveria të ofrojë zgjidhje për t'i dhënë fund grevës në arsim. Sipas tyre, është obligim i qeverisë t'i kthejë fëmijët në shkolla. Ndërsa kryeministri Albin Kurti dhe ministrja e Arsimit kanë thënë se janë adresuar të gjitha "kërkesat e arsyeshme" të sindikalistëve. Kurti ka thënë se pranon arsyeshmërinë e Këshillit Grevist se janë shtrenjtuar çmimet e shportës ushqimore dhe ka inflacion, por mënyra sesi zgjidhet kjo, sipas tij, nuk janë përmes kërkesave të tyre dhe ai nuk mund t'i plotësojë ato



EPOKA E RE Lirim GECI

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës të enjten kanë vazhduar debatin parlamentar për grevën në arsim, e cila ka hyrë në javën e katërt.

Deputetët e partive opozitare kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës të ofrojë zgjidhje për t'i dhënë fund grevës në sektorin e arsimit në Kosovë. Sipas tyre, është obligim i qeverisë t'i kthejë fëmijët në shkolla. Ndërsa përfaqësuesit e pushtetit kanë thënë se janë adresuar të gjitha kërkesat e sindikalistëve.

Fillimisht, nënkryetari i Kuvendit nga radhët e PDK-së, Enver Hoxhaj, e ka kritikuar qeverinë për gjendjen në arsim. Ai ka thënë se kryeministri Albin Kurti nuk duhet ta luajë rolin e të fortit në raport me sindikatat, as me opozitën. "Jemi në shtator dhe i kemi 22 ditë humbje të mësimit. S'po flas sot si deputet, jemi prindër që kemi nxënës në shkolla publike dhe dimë se sa e dëmshme është humbja e këtyre javëve të para të vitit shkollor. Kryeministri Kurti ka thënë këtu në kuvend që arsimi është prioritet. Fakti që nuk po ka vullnet që të kërkojë konsensus me sindikatën tregon goxha shumë ku jemi në shtatorin e vitit 2022. I bëj thirrje që të bisedoj me sindikatën dhe mësimdhënësit. Nuk e kemi ftuar këtë seancë për një grusht votash, por për faktin që është një gjendje alarmante dhe nuk dihet kur përfundon. E ftoj kryeministrin Kurti që s'ka nevojë ta luajë rolin e të fortit në raport me sindikatat, as me opozitën, por ta kuptojë në thelb se si duket procesi demokratik. Nëse nuk dialogon me sindikatën, është politikë e nënshtrimit", ka deklaruar Hoxhaj.

Ndërsa deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, ka thënë se, për dallim nga vajza e kryeministrit Kurti, vajzat e saj arsimohen në shkolla publike të Kosovës. "Kryeministri po harron që ministre të Arsimit e ka zonjën Nagavci, e cila në kohën e zgjedhjeve lokale e ka penguar reformën në arsim të ish-kryetarit të Kamenicës, Qëndron Kastrati. Unë nuk kam dal për t'i dhënë mbështetjen e plotë sindikatës, sepse me të vërtetë edhe kjo që bëhet është lojë e patakt, me e portretizu opozitën kinse po e mbështet sindikatën në mënyrë që t'i kundërvihet kësaj qeverie. Në fakt, ne vetëm po kërkojmë që ata ta bëjnë punën e tyre. Për dallim prej kryeministrit, vajza ime është në shkollë publike, ndërsa i nderuari (kryeministri Kurti) e ka vajzën në Norvegji, edhe besa shumica prej jush", ka thënë ajo.

Në anën tjetër, deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj, ka thënë se barrën kryesore për gjetjen e një zgjidhje për ndërprerjen e grevës e ka qeveria. "Mendoj që nuk kemi kohë për të humbur, pasi janë duke pësuar nxënësit që janë e ardhmja e Kosovës. Duke pësuar janë edhe mësimdhënësit nga nevoja e tyre mbi kërkesat e parashtruara. Janë duke pësuar edhe prindërit të cilët duhet të mos punojnë për t'u përkujdesur për fëmijët, duke pësuar janë të gjithë qytetarët të cilët kanë nevojë për t'i kryer punët dhe shërbimet e tyre nëpër institucionet komunale dhe shtetërore. Mbi këto fakte nuk është mirë që kryeministri t'i ofendojë grevistët duke ua vënë në pikëpyetje sinqeritetin dhe motivet e kërkesës", është shprehur Lekaj, duke shtuar se është koha për zgjidhje. "U bë mjaft me kokëfortësi, palët fajësojnë njëra-tjetrën dhe nuk ka zgjidhje. Është koha që qeveria të bëjë zgjidhje. Prandaj ju bëj thirrje t'i plotësoni kërkesat e sindikatave dhe shteti të kthehet në normalitet sa i përket funksionimit të administratës shtetërore dhe vazhdimit të mbajtjes së mësimit në shkollat dhe çerdhet e Kosovës. E vetmja adresë që mund të bëjë zgjidhje është kryeministri i Kosovës. Askush tjetër", ka thënë Lekaj.

Më tutje, deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka thënë se kryeministri Albin Kurti është fajtori kryesor për grevën në arsim. Ai nga foltorja e Kuvendit, i ka kërkuar Kurtit që ta zgjidhë krizën në arsim. Ai i ka propozuar Kurtit të bëhet edhe ministër i Arsimit. "Vendose masën e dhunshme edhe në arsim sikurse në shëndetësi dhe zgjidhe problemin. Po pajtohemi, e ke vendosur një masë të veçantë - të jashtëzakonshme në shëndetësi, pas pandemisë, vendose edhe në arsim dhe merri të gjitha kompetencat, e ke atë mundësi dhe zgjidhe krizën - ktheji nxënësit në shkollë. Mos dil këtu të vajtosh për sindikatat duke e bërë personalitet të pakontestueshëm ose të kontestueshëm një sindikalist i cili i ka të drejtat e veta legjitime", ka thënë Shala.

## Kurti: Viktima të grevës janë vetëm nxënësit dhe mësimdhënësit

Pas kritikave të opozitës për situatën në arsim, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është deklaruar të enjten në Kuvend. Ai ka thënë se më 1 shtator në mbrëmje bashkë me ministrin e Financave e kanë takuar kryetarin e BSPK-së dhe këshilltarin e tij dhe aty iu kanë ofruar që pakon për përballje me inflacion ta paralajmërojnë bashkë. "Unë jam interesuar që si socialdemokrat t'i forcoj sindikatat. E kam ofruar BSPK-së që paralajmërimin e pakos ta bëjmë bashkë. Nuk ka pranuar, ndonëse ajo pako është shumë e favorshme jo vetëm për sindikatën, por për gjithë popullin. Isha i interesuar ta forcoj sindikatën dhe e kam takuar e i kam bërë ofertën që s'është pranuar. Më 3 shtator në konferencë për medie e bëjmë këtë pa kreun e BSPK-së, pra pakon e 150 milionë eurove, kur i shtohen pakos së ringjalljes ekonomike rreth 200 milionë euro nga pranvera e tejkalon atë 300 milionëshin e vitit të kaluar. Vjet kemi qenë rreth 4 për qind të produktit vendosur si mbështetje, sivjet jemi me 5 për qind. Pra ka ekzistuar oferta për BSPK-në. Ma gjeni ndonjë qeveri që ndan një sukses të tillë me sindikatat paraprakisht. Jemi refuzuar. Më pastaj ne takohemi me datën 13 shtator me Këshillin Grevist", ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se ka kërkuar që ta takojë kreun e BSPK-së me dashamirësi dhe ministrja e Arsimit është ajo që takon kreun e SBAShK-ut. "Jam për ta ndarë publiken prej privates, nuk jam për ta zhdukur linjën dalluese, prandaj në institucione jemi zyrtarë. Dhe me datë 13 shtator kam pasur dy ministrat me vete, e kemi takuar Këshillin Grevist, në këtë takim ne, përveç pakos së përballjes me inflacion, ofruam tri gjëra shtesë: E para që publikisht të dalim të paralajmërojmë që më 15 shtator del për diskutim publik Projektligji i ri për Paga. As kjo nuk u pranua. E dyta, thamë 10 milionë shtesë për barërat esenciale dhe natyrisht që atmosfera në takim ishte e mirë. E treta ishte reforma e skemës sociale dhe pensionale, me ç'rast kategorizimin me pragun prej 15 vjetëve po e bëjmë të diferencohet dhe po e zvogëlojmë me krejt çfarë mundemi e dimë, për pabarazinë që është bërë. Ne insistuam që të kalohet paraprakisht këtu në Kuvend miratimi i reformës që bëhet me mbështetjen e Bankës Botërore. Në atë takim s'kanë mundur të na refuzojnë sepse dilnin absurd. Por çfarë na thanë: Po e konsultojmë anëtarësinë. S'kam dashur të flasë fare për medie derisa të kthehen në takim. Po të thoshin në takim i refuzojmë, do të dilnin absurd. Pasi që dalin nga takimi ynë, dalin para medieve dhe thonë se greva vazhdon", është shprehur Kurti.

Më tutje, Kurti ka thënë se s'ka kurrfarë viktimash në SBAShK, as në qeveri, por vetëm te mësimdhënësit dhe nxënësit. "Nuk kanë mundur ta kontaktojnë anëtarësinë më tepër se një person në telefon. Në vend që t'u thonë medieve diskutimet vazhdojnë, thanë grevat vazhdojnë. Ky s'është dialog social. Prandaj jemi në këtë krizë. S'ka munguar as komunikimi, as dialogu. Mungon sinqeriteti. Për mua është e qartë se këtu nuk janë kurrfarë viktimash krerët sindikalë e as ne si qeveri e as ju si deputetë, por janë nxënësit, mësimdhënësit, arsimi, e ardhmja e shtetit tonë. Tash me këtë polarizim të skajshëm ka përpjekje të vazhdueshme për viktimizim të individëve personalë. Por bëhet fjalë për popullin, jo vetëm për tash, por edhe për ata që vijnë pas nesh sepse sot përcaktohet e ardhmja. Çfarë gjuhe u përdor, kush u ofendua, a e dëgjove çfarë i tha, mendoj se janë pikërisht për zhvendosje të vëmendjes dhe mosadresim të çështjes", është shprehur ai.

Kurti ka thënë se derisa ai ishte në Bruksel, duke diskutuar me presidentin serb Aleksandër Vuçiq, në Kosovë ishte shpallur greva në arsim. "Greva nga BSPK është shpallur më 17 gusht, ditën që jam nisur për në Bruksel, e po atë ditë është shpallur udhëheqës i Këshillit Grevist, Rrahman Jasharaj. Isha pesë orë në diskutim me presidenten serb, e lajmi në Kosovë ishte se në Kosovë fillon greva. Pra kishin një kryeministër që po diskutonte me fqinjin tonë agresiv e dashakeq derisa në shtëpi paralajmërohet greva. Tash këtu dy deputetë besoj që e thanë të vërtetën e kësaj polemike, deputeti Pal Lekaj i AAK-së dhe deputeti Ferat Shala i PDK-së. Ata treguan qartë se e kanë me mua e jo me arsimin. Pa numër herë secili thotë kryeministri, kryeministri. Ata kanë probleme me mua, në rregull, se për këtë është opozita, por s'e kanë as me arsimin, as me grevën, as me Rrahman Jasharaj e me ministren, por me mua. Në thelb të gjithë kësaj është një mosnjohje kronike. Rezultati i 14 shkurtit të kaluar. Për besë ky është problemi, por do të

# Protestojnë sindikalistët e MPJD-së, kërkojnë të kthehet rendi kushtetues në shërbimin e jashtëm

**Prishtinë, 22 shtator** - Shoqata Sindikale e Anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm ka protestuar të enjten para objektit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) lidhur me keqpërdorimet në këtë ministri. Organizatorët e kësaj proteste kanë parashtruar një varg kërkesash drejtuar MPJD-së duke apeluar që menjëherë të kthehet rendi kushtetues dhe ligjshmëria e përligjur në Shërbimin e Jashtëm.



Albert Prenkaj nga kjo shoqatë sindikale ka thënë se kjo protestë është akt publik dhe do të jetë proces i vazhdueshëm i shprehjes së pakënaqësive me veprimet dhe vendimet që i ka quajtur të jashtëligjshme dhe arbitrare të menaxhmentit të MPJD-së. “Kemi dalë sot këtu ta shprehim pakënaqësinë, indinjatën dhe mospajtimin me zhvillimet e fundit në këtë ministri. Kjo protestë sot është akt publik dhe do të jetë e vazhdueshme për shprehjen e pakënaqësive tona lidhur me veprimet arbitrare të kësaj ministrie. Kjo që po ndodh sot është e paprecedent, asnjëherë në të kaluarën nuk ka ndodhur në një formë të tillë, përkundër vërejtjeve që kemi shprehur edhe në të kaluarën ndaj menaxhmenteve paraprake”, ka thënë Prenkaj, duke theksuar se jemi dëshmitarë të një presioni të secilit prej nesh dhe kemi kolegë që largohen të frikësuar.

“Në MPJD janë instaluar në mënyrë të jashtëligjshme sistemi i kërcënimit, shantazhimit dhe privilegjeve të pamerituara në mënyra të ndryshme. Kjo mënyrë e të funksionuarit ndaj diplomatëve është në kundërshtim me Kushtetutën e shtetit tonë, duke u prekur liria, demokracia dhe të drejtat e njeriut”, ka thënë Prenkaj.

## Protestojnë disa prindër, kundërshtojnë grevën, kërkojnë hapjen e çerdheve

**Prishtinë, 22 shtator (ER)** - Këshilli i Prindërve i Institucionit Parashkollor “Gëzimi Ynë” në Prishtinë ka protestuar para objektit të qeverisë duke kërkuar hapjen e çerdheve. Prindërit kanë nisur marshin me pankarta në duar me shkrimet: “Nënat po i humbin vendet e punës”, “Mos ua prishni lumturinë”, “Hapeni çerdhet” etj.

Teuta Jahaj ka thënë se mbyllja e kopshteve është e paarsyeshme dhe e papërballueshme pasi, sipas saj, janë detyruar të marrin pushim nga puna dhe t’i dërgojnë fëmijët në çerdhe private. “Arsyeja e protestës është që gati një muaj janë mbyllur kopshtet dhe për ne si prindër është e paarsyeshme dhe e papërballueshme mbyllja e këtyre kopshteve dhe për këtë arsye kemi dashur që të bëjmë një protestë simbolike që kërkesat tona të reflektojnë ndaj qeverisë. Pasojat janë se është dashur të marrim pushime vjetore dhe dihet qe ne që jemi në sektorë privatë nuk mund të marrim pushime. Shumica është dashur t’i dërgojë fëmijët në kopshte private”, ka thënë Jahaj.

Pas qeverisë, ata kanë shkuar te zyrat e Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBAShK).






# Memli Krasniqi, Albin Kurtit: Lëviz, o njeri!

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, i ka quajtur paranojake deklaratat e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, se të gjithë kanë dalë kundër tij. Krasniqi është tallur edhe me satirën e Kurtit për termin “vëlla”. “Problemi është se nuk janë krejt tu u marrë me Albin Kurtin, por Albin Kurti duhet me u marrë me krejt. Ai në ato bindjet e tyre shumë problematike, mendon se krejt po mendojnë për të. Njerëzit janë duke menduar për telashe të veta. Na kanë shti në sandviç, në njërën anë qeveria, në anën tjetër sindikata. Kush është humbësi? Këtu humbës, para së gjithash, janë fëmijët, prindërit dhe mësimdhënësit. A përnime po mendoni se arsimtarët nuk po dojnë me shku në shkollë? A përnime po mendoni se kreu i sindikatës i kontrollon ata si me ‘joystick’ a?”, ka deklaruar Krasniqi, duke shtuar se Kurti nuk e njeh realitetin në Kosovë meqë, sipas tij, nuk po del asnjëherë nga zyra e tij. “Ty kryeministër nuk të ka parë njeri i lem e i gjallë duke dalë prej zyre. Nuk ka mujtë kryeministri me shkua deri në Rahovec me i pa njerëzit që i ka marrë uji. Duke e kultivuar atë arrogancën që e ka, ai po thotë që krejt janë kundër meje. Qe s’po i thojmë o vëlla se po nervozohet, lëviz, o njeri!”, ka thënë Krasniqi, duke shtuar se grevat janë kthyer në një fenomen dhe nuk po ndodhin vetëm në arsim. “Sot po e vazhdojmë diskutimin ku e kemi nisë para një jave, për grevat në arsim, por jo vetëm edhe në arsim. Në grevë janë edhe shërbyesit civil, edhe administratat në universitet publike dhe të gjitha komunat e Kosovës. Pra, nuk është problemi vetëm me arsimin. Duhet ta kemi parasysh se janë edhe dhjetëra e mijëra punëtorë të tjerë të cilët janë duke grevuar. Për më shumë, sot e pamë që kishte grevë njëorëshe në MPJD. Ka pasur paralajmërime për greva edhe në sektorin e shëndetësisë. Pra, na jemi duke folur për një situatë, ku krejt shteti është në rrezik me u bllokuar”, ka paralajmëruar Krasniqi.

tejkalohet. S’kam çfarë bëj unë, se populli ka votuar. Halli është se jam unë kryeministër, jo pse s’po shkojnë fëmijët në shkolla. Greva po përdoret si armë kundër kryeministrit. Ky është synimi i qartë që u shpalos sot nga këta dy deputetë. Kur këto dy parti ishin si PAN-i, bëhej memorandum bashkëpunimi me SBAShK-un, pra më 5 qershor, PAN-i me SBAShK-un”, është shprehur Kurti.

Shefi i qeverisë ka thënë se janë adresuar të gjitha “kërkesat e arsyeshme” të sindikalistëve të arsimit. Ai ka thënë se e pranon arsyeshmërinë e Këshillit Grevist, se janë shtrenjtuar çmimet e shportës ushqimore dhe ka inflacion, por mënyra si zgjidhen këto, sipas tij, nuk janë përmes kërkesave të tyre dhe ai nuk mund t’i plotësojë ato. “Kërkesa e saktë (e sindikatave) ka qenë ‘derisa të kalojë Projektligji për Paga na jepni nga 100 euro në muaj’. Ne e kemi bërë dimensionimin ndryshe, duke e dëgjuar arsyetimin. Arsyetimi thotë është shtrenjtuar shporta elementare ushqimore. Kjo është e drejtë, por meqenëse është shtrenjtuar shporta ushqimore, ‘m’i jep 100 euro për muaj derisa të zbatohet Ligji për Paga’. Nuk e bëjmë dot”, ka thënë Kurti.

Ndërsa ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka thënë se qeveria ka përmbushur mbi 90 për qind të kërkesave të SBAShK-ut. “Trajtimi i dinjitetshëm i mësimdhënësve bëhet përmes Ligjit për Paga dhe ne këtë e kemi bërë. I kemi trajtuar më mirë se kurdoherë. E kemi ndarë këtë Projektligj me SBAShK-un, por nuk kemi marrë asnjë koment. Projektligji është në dëgjim publik dhe nuk e di se ju deputetë a e keni lexuar për të parë se si i kemi trajtuar mësimdhënësit. Kemi përmbushur mbi 90 për qind të kërkesave të SBAShK-ut, por ata e kanë çdoherë vetëm një kërkesë. Thonë: ‘Lëvizni edhe pak’. Pra, kjo nënkupton që ato 50 eurot që i kemi ndarë, thonë rritni edhe pak, 10 euro, 15 apo 20. Nuk mendoj se kjo i bën nder as dinjitetit të mësimdhënësve, as neve si qeveri e as sindikatës”, ka thënë Nagavci.

Kurse shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se fëmijët po ballafaqohen me një situatë që s’e kanë shkaktuar e as krijuar me grevë por, sipas saj, po i bartin pasojat. Kusari-Lila ka thënë se greva e BSPK-së është e garantuar me ligj por, sipas saj, sa herë që shfrytëzohet një e drejtë duke i shkaktuar dëm dikujt tjetër, atëherë bëhet keqpërdorimi i asaj të drejte. “Dëmi që po u shkaktohet fëmijëve është me pasoja të parikuperueshme për një të ardhme afatmesme dhe një konstatim është bërë edhe nga Avokati i Popullit si institucion i pavarur për t’i mbrojtur të drejtat e individëve”, është shprehur Kusari - Lila.

Mësimdhënësit e të gjitha institucioneve publike janë në grevë, me kërkesën për mbështetje financiare prej 100 eurosh në muaj deri në fillimin e zbatimit të Projektligjit për Paga. Përjashtim bëjnë vetëm disa mësimdhënës që individualisht kanë nisur t’i mbajnë orët.

Paga aktuale e mësimdhënësve në shkollat fillore të Kosovës është 470 euro, ndërsa me ligjin e ri pritet të arrijë në 620 euro. Mësimdhënësit e shkollave të mesme aktualisht marrin nga 530 euro dhe kjo shumë pritet të rritet në 696 euro. Projektligji për Paga, nga data 15 shtator deri më 6 tetor, është në procedurë të konsultimeve publike, më pas ai duhet të miratohet në qeveri dhe Kuvend dhe të publikohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës. Ligji hyn në fuqi tetë muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

## Pjetër Shalës i vazhdohet masa e paraburgimit



HAGË, 22 SHTATOR - Më 21 shtator, ditën që i është transferuar lënda për gjykim trupit gjykues, gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, ka marrë vendim që ish-eprorit të UÇK-së, Pjetër Shala, t'i vazhdohet masa e paraburgimit. "Gjyqtari i procedurës paraprake konkludon, për qëllime të shqyrtimit periodik të paraburgimit të z. Shala, në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullin 57(2) të Rregullores, se rreziqet që z. Shala do të arratiset, pengojnë ecurinë e procedurave të DhSK-së, ose kryerje të krimeve të mëtejshme kundër atyre që perceptohen si kundërshtarë të UÇK-së, duke përfshirë dëshmitarët që i kanë ofruar dëshmi Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe/ose që duhet të paraqiten para Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK), vazhdojnë të ekzistojnë", është thënë në vendim e Gjykatës Speciale.
Me anë të vendimit, gjyqtari i procedurës paraprake po ashtu ka urdhëruar mbrojtjen që nëse dëshiron të parashtrojë shkresa për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të Shalës, këtë ta bëjë jo më larg se më 25 tetor, ndërsa përgjigjja e prokurorisë duhet të bëhet jo më larg se më 1 nëntor.
Pjetër Shala është arrestuar më 16 mars 2021 nga autoritetet belge dhe është transferuar në Hagë më 15 prill 2021 në bazë të një kërkese për bashkëpunim në zbatimin e fletarrestimit dhe urdhrit për transferim lëshuar nga Gjykata Speciale. Në aktakuzën e konfirmuar, Shala ngarkohet me përgjegjësi penale individuale në forma të ndryshme për krime lufte si ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme, të kryera në kontekstin e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe në lidhje me këtë konflikt.

# Haxhiu takohet me Trendafilovën, diskutojnë për punën e Gjykatës Speciale



PRISHTINË, 22 SHTATOR (ER) - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka pritur të enjten në takim kryetaren e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova. Përgjatë këtij takimi është bërë me dije të jetë diskutuar për punën e kësaj gjykate, përgjegjësitë e saj, të drejtat e palëve në procedurë, rolin e Avokatit të Popullit dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.
Kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, ka mbajtur të mërkurën një konferencë online për medie, në të cilën ka folur në mënyrë kronologjike për ecurinë e proceseve gjyqësore kundër përfaqësuesve të UÇK-së të cilët janë duke u mbajtur në paraburgim nga viti 2020. Kjo konferencë ishte paraparë të mbahej në Gjilan, mirëpo është anuluar pasi ishte paralajmëruar një protestë kundër vizitës së saj nga ana e Partisë Socialdemokrate (PSD), e cila ishte e mbështetur edhe nga disa degë të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).
Duke folur për rastin e liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, kryetarja Trendafilova ka bërë me dije se më së largu deri në fillimin e vitit 2023 pritet të fillojë shqyrtimi kryesor në rastin e katër drejtuesve të UÇK-së. "Është e pritshme që në një rast të tillë, deri në fund të këtij viti, më së voni në fillim të vitit të ardhshëm, do të fillojë procedura, sepse gjyqtarët janë marrë me shqyrtimin e të gjitha dokumenteve të rëndësishme të rastit. Gjyqtari i procedurës paraprake është duke punuar në çdo moment dhe duke angazhuar edhe festat e pushimit, bashkë me një ekip shumë të përkushtuar, por rasti është shumë i madh. Gjyqtarët janë shumë kërkues, kërkojnë shumë që të njohin çdo aspekt të materialeve dhe provave si dhe respektojnë në mënyrë të rreptë çdo afat kohor", ka thënë Trendafilova, duke shtuar se nuk ka dijeni nëse do të ngrehen aktakuza të reja. "Nuk e di se cilat janë intencat e prokurorit. Ajo që prokurorët bëjnë është nëse e hetojnë ndonjë krim të lidhur me ngjarjet ose njerëzit e tjerë që gjoja kanë kryer krime që bien në mandatin tonë dhe juridiksionin tonë. Kjo është diçka që unë nuk e di. Prokurori do të më njoftojë para se të dalë me ndonjë kërkesë për konfirmim të aktakuzës në mënyrë që unë ta vë njoftimin dhe unë e caktoj edhe gjyqtarin e procedurës paraprake. Natyrisht, nëse kjo ndodh brenda një periudhe të caktuar kohore, aktivitetet e tilla mund të jenë konfidenciale, por deri më tani mund t'ju them se nuk ka asgjë", ka deklaruar Trendafilova.
Gjykata Speciale është krijuar mbi bazën e raportit të Dick Martyt, ku nga nëntori i vitit 2020 janë duke u mbajtur në paraburgim drejtuesit kryesorë të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi qysh në daljen e parë para trupit gjykues janë deklaruar të pafajshëm në lidhje me akuzat e prokurorisë. Përpos tyre, në qendrën e paraburgimit në Hagë janë duke u mbajtur edhe Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Sali Mustafa dhe Pjetër Shala.

## "Cali" mbetet në paraburgim, trupi gjykues thotë se ekziston rreziku i pengimit të procedurave



HAGË, 22 SHTATOR - Trupi gjykues, i kryesuar nga Mappie Veldt- Foglia, ka marrë vendim, me anë të të cilit i është vazhduar masa e paraburgimit Salih Mustafës, gjykimi i të cilit ka përfunduar më 15 shtator dhe i njëjti është në pritje të vendimit të trupit gjykues. Sipas vendimit, trupi gjykues ka gjetur se nuk ekziston rreziku i arratisjes së Mustafës, mirëpo ka konkluduar se ekziston rreziku që i akuzuari ta pengojë përparimin e procedurave përmes interferimit në viktima, dëshmitarë ose me familjarë të tyre.
Në pjesën kur flitet për rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera është thënë se, pasi paneli ka konstatuar se ekziston një mundësi mjaft reale që i akuzuari ta pengojë përparimin e procedurave të Gjykatës Speciale, duke përfshirë ndërhyrjen me viktimat dhe dëshmitarët ose familjet e tyre, ka konstatuar se nuk ka nevojë ta adresojë rrezikun sipas nenit 41(6) - (b)(iii) të ligjit. Po ashtu, trupi gjykues ka theksuar se nuk ka gjetur se i akuzuari është në paraburgim për periudhë të paarsyeshme. Aktakuza ndaj Mustafës, i njohur si komandat "Cali", ishte konfirmuar më 12 qershor 2020.

# Përkujtohen Fehmi dhe Xhevë Lladrovci: Ata janë themel i Kosovës së lirë!

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Të enjten është shënuar 24-vjetori i rënies heroike të komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fehmi Lladrovci, dhe bashkëshortes së tij, Xhevë Krasniqi-Lladrovci, po ashtu një ndër luftëtarët e para të UÇK-së. Çifti Fehmi e Xhevë Lladrovci ishin ndër figurat më emblematike të organizimit dhe luftës për liri në Kosovë, të cilët kanë rënë më 22 shtator të vitit 1998, në një betejë të vështirë e të pabarabartë me forcat serbe, pas një qëndrese heroike të Fehmiut, Xhevës dhe luftëtarëve të tjerë të UÇK-së në fortesat e ngritura në Çiçavicë.

Bashkë me ta ka rënë edhe studentja Fatime Hetemi dhe shumë dëshmorë të tjerë. Fehmi Lladrovci ishte komandant i Brigadës 114 i UÇK-së, emrin e të cilit do ta mbajë kjo brigadë. Në sheshin e Drenasit janë vendosur shtatoret e dëshmorëve Fehmi dhe Xhevë Lladrovci.

Në 24-vjetorin e rënies heroike, Fehmi dhe Xhevë Lladrovcit, janë përkujtuar nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe liderët partiakë. Me këtë rast, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë homazhe te shtatoret e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci në Drenas.

Kurti ka thënë se Fehmi e Xhevë Lladrovci janë pjesë e historisë moderne të Kosovës. "Që nga vitet '80- e tutje, emri i Fehmi Lladrovcit haset kudo ku kishte veprimtari politike dhe ushtarake për çlirimin e Kosovës nga Serbia. Por ashtu siç emri i Azem Galicës rëndom përmendet bashkë me emrin e gruas së tij Shotës, edhe emri i Fehmi Lladrovcit është bërë i pashqitshëm nga emri i gruas së tij Xhevë Krasniqit. Fehmi dhe Xhevë Lladrovci janë ndër figurat kyçe të organizimit dhe ngritjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe, si të tillë, bashkërisht, ata janë bërë pjesë e historisë moderne të Kosovës, asaj historie që ata e kanë bërë dje, kurse neve na takon ta kujtojmë dhe shkruajmë sot", ka thënë Kurti.

Ndërsa kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se Fehmiu dhe Xheva ishin sinonim i qëndresës, fuqisë e motivimit të UÇK-së. "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci ishin sinonim i qëndresës, fuqisë dhe motivimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Fehmiu dhe Xheva janë themelet e Kosovës së lirë, Kosovës shtet. Së bashku me Fatime Hetemi dhe Shefqet Zeka, të rënë po atë ditë, ata u bënë inspirimi i të gjithë brezave. Përjetësisht mirënjohje e nderim", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".





## Krasniqi: Akti sublim i heroizmit të Fehmi e Xhevë Lladrovcit, shembull i sakrificës për çlirimin e Kosovës

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, me bashkëpunëtorë ka bërë homazhe të enjten në memorialin e dëshmorëve të UÇK-së në Gllanasellë, në përvjetorin e 24-të të rënies heroike të Fehmi e Xhevë Lladrovcit. Në "Facebook", Krasniqi është shprehur se akti sublim i heroizmit të Fehmi e Xhevë Lladrovcit do të përcillet ndër breza si shembull i sakrificës për liri. "Akti sublim i Fehmiut dhe Xhevës do të përcillet ndër breza si shembull se dashuria për atdhe dhe sakrifica për çlirimin e Kosovës është fati që përcjell çdo atdhetar. Lavdi e përjetshme për heronjtë dhe dëshmorët e kombit, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Fatime Hetemi, Shefqet Zeka, Behxhet e Milazim Karaxha dhe Hamit Lladrovci!", ka shkruar Krasniqi.

# Ushtarët e FSK-së përfundojnë me sukses ushtrimin fushor në Gjermani

Prishtinë, 22 shtator (ER) - Kontingjenti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) ka përfunduar me sukses pjesëmarrjen në ushtrimin fushor "Saber Junction 2022", i mbajtur në bazën ushtarake amerikane në Hohenfels të Gjermanisë.

Kontingjenti i FSK-së ka qenë i bashkangjitur te batalioni i parë i regjimentit të katërt të këmbësorisë (1-4 IN) dhe me sukses ka ekzekutuar operacione sulmuese dhe mbrojtëse gjatë ushtrimit me qëllim që t'i zhvillojë dhe avancojë aftësitë operacionale si forcë opozitare duke vepruar dhe koordinuar ngushtë me pjesëmarrësit në ushtrim me qëllime të arritjes së ndërveprueshmërisë me partnerët.



## Më 29 shtator mbahet ankandi i dhjetë i letrave me vlerë për vitin 2022

Prishtinë, 22 shtator (ER) - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 29 shtator 2022 do të mbahet ankandi i dhjetë për vitin 2022. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet pesëvjeçar në shumën prej 10 milionë eurosh. “Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (5 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi”, ka njoftuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Kjo ministri ka bërë me dije se për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë duhet të kontaktohet ndonjëra nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë.



# Biznesmeni Shkëlqim Devolli takon ish-sekretarin amerikan të Shtetit, John Kerry

Uashington, 22 shtator (ER) - Drejtuesi i njërës prej korporatave më të mëdha në Kosovë, “Devolli Corporation”, Shkëlqim Devolli, është duke vazhduar qëndrimin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), ku është duke zhvilluar shumë takime me politikëbërës dhe sipërmarrës amerikanë.

Devolli ka takuar të enjten ish-sekretarin amerikan të Shtetit, John Kerry, i cili ka qëndruar edhe në Kosovë sa ishte në detyrë.

Kerry, i cili sot mban postin e emisarit special të presidentit Biden për ndryshimet klimatike, ka folur me afaristin kosovar për zhvillimet në Kosovë dhe rajon, kurse ky i fundit e ka falënderuar ish-sekretarin e Shtetit për angazhimin e tij për Kosovën. Po ashtu, Shkëlqim Devolli ka takuar edhe kryetarin e Nju-Jorkut, Eric Adams, të cilit i ka treguar se biznesi i parë i korporatës me shtetin amerikan ka qenë hapja e “Prince Coffee House” në këtë qytet. Devolli në fillim të javës ka takuar edhe njërin nga politikanët më të popullarizuar në ShBA, Ted Cruz, në zyrat e Senatit, si dhe guvernatorin e shtetit të Teksasit, Greg Abbott, me të cilët ka diskutuar për temat e bashkëpunimit ekonomik ShBA - Kosovë.



# Murati thotë se për shkak të ndihmës së qeverisë, sot qytetarët kanë më shumë para në banka






Prishtinë, 22 shtator (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se për shkak të ndihmës së qeverisë, qytetarët e Kosovës sot kanë më shumë para në banka. Sipas tij, në fillim të vitit ka pasur rënie të depozitave të qytetarëve për shkak të luftës në Ukrainë. “Një indikator i rëndësishëm i ekonomisë është edhe niveli i depozitave të qytetarëve në sistemin bankar. Në fillim të vitit kishte një rënie të theksuar të nivelit të depozitave si rezultat i luftës që nisi në Ukrainë. Për shkak të rritjes së çmimeve e rrezikut të mbylljes së kufijve, qytetarët e bizneset nxituan të furnizoheshin me mallra, gjë që shkaktoi një rënie të nivelit të likuiditetit në ekonomi. Mirëpo trendi kthehet në pozitiv në muajin prill, kur nis zbatimi i pakos mbështetëse për qytetarët në vlerë prej 100 milionë eurosh, ku përfituan familjet në asistencë sociale, punëtorët e sektorit publik dhe privat, pensionistët e studentët. Një gjë tjetër interesante që vërehet është edhe kontributi i jashtëzakonshëm i mërgatës sonë në muajin korrik, atëherë kur edhe fillon ardhja masive e tyre në vendlindje, ku depozitat bankare shënojnë nivel rekord. Në fund të muajit korrik niveli i depozitave në valutën euro ishte 4.88 miliardë euro”, ka shkruar Murati në llogarinë e vet në “Facebook”.

Ndaj këtij vlerësimi të Muratit ka reaguar deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Besian Mustafa. Ai ka thënë se “qytetarët po kanë aq shumë para në banka sa që po ikin jashtë vendit”. “Tregoni dikush ministrit të Financave se aq shumë po kanë qytetarët para në banka saqë 100 000 djem e vajza e kanë lëshuar Kosovën prej kur ka ardhur ministri në pushtet”, ka shkruar Mustafa në “Facebook”.

## Procedohet për mendim në qeveri Projektligji për Trustin

Prishtinë, 22 shtator (ER) - Kryesia e Kuvendit e Kosovës të enjten ka mbajtur mbledhjen e radhës. Me këtë rast, kryesia ka proceduar për mendim në Qeverinë e Kosovës disa projektligje. “Kryesia procedoi për mendim në qeveri Projektligjin për Pensionet e Zyrtarëve Policorë të Policisë së Kosovës dhe punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore si dhe Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-115, me Ligjin nr. 04/L-168 dhe Ligjin nr. 05/L-116”, është thënë në njoftimin e Kuvendit të Kosovës.

Kujtojmë se Kuvendi në qershor i pati thënë jo tërheqjes nga Trusti. Menjëherë pati nisur një peticion. Më 15 korrik peticioni me 21 mijë nënshkrime është dorëzuar në Kuvend.



# 11 zgjidhje të lashta për problemet dhe sfidat e kohës tonë



Nga Arthur C.BROOKS

“Vëlla Galio, të gjithë njerëzit dëshirojnë të jetojnë të lumtur, por janë të paaftë ta perceptojnë saktësisht se çfarë e bën jetën të lumtur!”- i shkroi filozofi dhe burrështetasi romak Lusius Aneus Seneka vëllait të tij rreth vitit 58 Pas Krishtit.

Seneka mund ta jetë bazuar fare mirë tek vetja mbi atë që shkroi. Pasi ai ishte një ekspert i lumturisë, duke shkruar gjatë gjithë jetës mbi konceptin e lashtë të “eudaemonisë”, që përafërsisht do të thotë “të jetosh në paqe me natyrën”, ose ndoshta në gjuhën e sotme “paqe e brendshme”.

E megjithatë jeta e tij nuk ishte aspak e qetë. Pasi përjetoi për vite të tëra me probleme të rënda shëndetësore, Seneka u internua nga perandori romak Klaudi. Më pas u rikthye si këshilltar i perandorit Neron, nga i cili fillimisht u admirua, dhe pas u akuzua (ndoshta gabimisht) për komplot, dhe kështu u detyrua që të vriste veten.

Seneka e shkroi esenë e tij me titull “Për një jetë të lumtur” pikërisht gjatë atyre viteve të vështira me Neronin, në formën e këshillave për vëllanë e tij. Por s’ka dyshim se ato janë këshilla për të gjithë ne, se çfarë duhet të bëjmë për të ruajtur qetësinë përballë sfidave të vështira të jetës, shkruan bota.al.

**Mësimi nr. 1:** Reagoj me të njëjtën shprehje të fytyrës, si ndaj vdekjes ashtu edhe një komedie

Seneka nuk sugjeron të qeshni nëpër funerale apo qani në një komedi. Dhe as se trishtimi dhe e qeshura janë gjëra të këqija. Ai thjesht ju nxit t’i menaxhoni emocionet tuaja ekstreme, në mënyrë që ata të mos jenë ato që t’iu kenë nën kontroll. Dhe në fakt është një këshillë e shkëlqyer. Në vitin 2020, studiuesit francezë studiuan marrëdhënien midis një gjendjeje të barabartë mendore dhe masave të ndryshme të ndjenjës dhe sjelljes. Ata zbuluan se qetësia parashikonte gjendje më të ulëta negative, si mendimi i tepruar, mendimet katatrofike dhe neurotizmi.

**Mësimi nr. 2:** Unë do t’i përvishem punëve, sado të shumta të jenë ato, duke u mbështetur mbi forcën e trupit dhe mendjes time

Një nga leksionet më të mëdha nga kërkimet moderne është se të qëndruarit në formë, fizikisht dhe intelektualisht, janë thelbësore për një jetë të lumtur. Dy nga zakonet e përjetshme të njerëzve të moshuar që janë të lumtur dhe në gjendje të mirë shëndetësore, janë të mësuarit e vazhdueshëm dhe të qenit fizikisht aktivë. Pra lexoni dhe ecni çdo ditë, dy aktivitete që janë po aq revolucionare sot sa ishin edhe në kohën e Senekës. Ose nëse funksionon tek ju, ecni duke dëgjuar një audio-libër!

**Mësimi nr. 3:** Unë do t’i përçmoj pasuritë kur i kam, po aq sa kur nuk i kam. Nëse ato i përkasin dikujt tjetër, nuk do të bie në depresion. Pavarësisht nëse pasuria shkon e vjen, unë nuk do ndikohem aq shumë prej saj

Ky mësim, është shumë më i thellë se vetëm shprehja e njohur “Paraja nuk e blen lumturinë”. Pohimi i Senekës, është se një lidhje e fortë psikologjike dhe emocionale me pasurinë do të sjellë mjerim. Dhe këtë e mbështesin sot edhe studimet. Për shembull, në një studim të vitit 2017, botuar në revistën “Personality and Individual Differences”, studiuesit treguan se materializmi mund të ulë mirëqenien dhe të shtojë depresionin.

**Mësimi nr. 4:** Do t’i shoh të gjitha tokat sikur të më përkasin mua, dhe të miat sikur të ishin të gjithë njerëzimit

Ky mësim është një zgjatim i të tretit, dhe thekson se mjerimi në jetën e një njeriu, buron jo vetëm nga përvetësimi i gjërave materiale, por edhe nga mbajtja shumë pas vetes e asaj që ka dikush. Kjo ide është e pranishme në shumë tradita fetare dhe filozofike.

Për shembull, është e ngjashme me atë që katolikët e quajnë “solidaritet”. Pra ideja që ne jemi të gjithë motra dhe vëllezër. Prandaj pronësia ime mbi pronën time, është në thelb një pronësi e kujdestarisë për të mirën më të madhe të së gjithëve.

**Mësimi nr. 5:** Do të jetoj aq sa të kujtoj se kam lindur për të tjerët, dhe do ta falënderoj Nënën Natyrë për këtë arsye:në çfarë mënyre ajo mund të kishte bërë më mirë për mua? Ajo më ka sjellë në këtë botë për të gjithë, dhe gjithçka ka qenë për mua

Pra bamirësia është një dhuratë për dhënësin. Shërbimi ndaj të tjerëve, është një nga mënyrat më të lehta për t’u bërë më të lumtur. Shumë studime tregojnë se bamirësia dhe vullnetarizmi, e rritin mirëqenien e njeriut.

**Mësimi nr. 6:** Çfarëdo që mund të zotëroj, nuk do ta grumbulloj me lakmi, dhe as do ta shpërdoroj në mënyrë të pamatur

Ky mësim është një version i thënies së vjetër “Çdo gjë me masë!”. Sipas Senekës, një qasje e moderuar e nxit paqen e brendshme. Sërish, ky pretendim mbështetet nga studimet.

**Mësimi nr. 7:** Unë nuk do t’i llogaris përfitimet nga madhësia apo numri i tyre, përveç vlerës së caktuar nga marrësi

Për shembull, vlera e vërtetë e punës tuaj nuk është paga juaj, por sa shumë i ndihmoni të tjerët. Altruizmi nuk do t’ua paguajë qiranë e shtëpisë. Por nëse e ndiqni vërtet këtë mësim, ai mund të ndryshojë prioritetet tuaja, dhe ndoshta t’ju çojë në një punë më të mirë.

**Mësimi nr. 8:** Nuk do të bëj asgjë për shkak të opinionit publik, por gjithçka për shkak të ndërgjegjes:Sa herë që bëj diçka vetëm, do të sillem sikur mbi mua të jenë sytë e gjithëpopullit romak

Ky mësim është i dyfishtë: Së pari, t’i rezistosh krahasimit social; dhe së dyti, të veprosh në mënyrë private njëlloj si në ambiente publike. Mësimi i parë është një element kryesor në literaturën e psikologjisë, dhe ndoshta shpjegon se arsyen përse mediat sociale – ku ne e krahasojmë vazhdimisht veten me të panjohurit dhe miqtë – ndikojnë negativisht mbi mirëqenien e shumë njerëzve. Mësimi i dytë, pohon se integriteti dhe qëndrueshmëria çojnë në lumturi, ndërsa hipokrizia çon në pakënaqësi shkruan bota.al.

**Mësimi nr. 9:** Do të jem i pëlqyeshëm me miqtë e mi dhe i butë me armiqtë e mi:Do të fal para se të më kërkohet, dhe do të përmbush dëshirat e njerëzve të nderuar

Ky mësim i lashtë – Duajini armiqtë tuaj, siç predikon Bibla – qëndron pas shumë filozofive që kërkojnë të zbehin tendencën për të urryer armiqtë tanë. “Dashuria ka brenda saj një fuqi shëlbuese, e cila i transformon individët”- u shpreh Martin Luter King Jr. në një predikim të vitit 1957. Edhe në studimet e mia, unë kam vënë re se dashuria për atë që është ndryshe nga ne, nuk është vetëm praktike. Ajo mund të jetë edhe një burim gëzimi shumë i madh.

**Mësimi nr. 10:** Nuk do të harroj asnjëherë se qyteti im i lindjes është bota, se guvernatorët e saj janë Zotat, dhe se ata qëndrojnë sipër dhe rreth meje, duke kritikuar çdo gjë që bëj ose them

Pra unë nuk duhet të veproj vetëm kur më shohin të tjerët. Por duhet të veproj sikur po mësheh Zoti. Një studim tregoi se nëse besimtarët dhe jobesimtarëve mendonin njëlloj mbi Zotin përpara se të përfshiheshin në një eksperiment në të cilin ata mund t’i jepnin vullnetarisht para një të huaji apo t’i mbanin për vete, ishin 2 herë më shumë bujari sesa kur nuk përfshiheshin konceptet fetare.

**Mësimi nr. 11:** Sa herë që Natyra kërkon sërish frymën time, unë do ta braktis këtë jetë, duke i thirrur të gjithë të dëshmojnë se kam dashur një ndërgjegje të mirë, dhe se liria e askujt, më së paku e imja, nuk është cenuar përmes meje

Ky mësim, na nxit ta konsiderojmë të mirën e të tjerëve, si mënyrën për të pranuar vdekjen tonë në një mënyrë paqësore. Dhe në fakt, një studim i vitit 2014 me pacientët e prekur ngakanceri që po vdisnin, zbuloi se pacientët paqësorë ishin “të përqendruar tek të tjerët”.

Ata e panë sëmundjen e tyre si një mundësi për t’u dhënë të tjerëve, qoftë duke inkurajuar miqtë, duke mësuar nipërit e mbesat për jetën. Apo duke marrë pjesë në prova klinike për të ndihmuar pacientët e ardhshëm. Thuhet se vetë Seneka vdiq në qetësi të plotë. Ai u detyrua të vrasë veten. Por e bëri këtë me qetësi, dhe duke folur për guximin që duhet të ketë njeriu në jetë dhe para vdekjes.

} *“The Atlantic” – Bota.al*





Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Fazliji dhe Emërllahu: Kërkojmë fitore ndaj Irlandës së Veriut

"Dardanët" mbajtën stërvitjen e fundit në Kosovë, kurse të enjten kanë udhëtuar drejt Belfastit për ndeshjen ndaj Irlandës së Veriut, e cila zhvillohet të shtunën në kuadër të Ligës së Kombeve. Betim Fazliji dhe Lindon Emërllahu kanë folur pas stërvitjes, ndërsa kanë paralajmëruar fitore në ndeshjen e radhës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të enjten paradite e ka zhvilluar stërvitjen e fundit para udhëtimit në Belfast. "Dardanët" e udhëhequr nga përzgjedhësi Giresse të shtunën e zhvillojnë përballjen e radhës në Ligën e Kombeve kudër Irlandës së Veriut në orën 18:00. Në seancën e fundit në Kosovë Giresse ka lejuar të mos jetë shumë e ngarkuar, pasi kryesisht është punuar në aspektin taktik.
Federata e Futbollit ka njoftuar pas kësaj stërvitje se të gjithë futbollistët janë në formë të mirë dhe të gatshëm për ta dhënë maksimumin e tyre në këtë ndeshje. Betim Fazliji, pas stërvitjes, ka thënë se motivi është i madh dhe se synim ndaj Irlandës së Veriut është fitorja. "Duam të shkojmë në Belfast me synim për ta dhënë maksimumin. Secili prej nesh është i motivuar për fitore në Irlandën e Veriut. Kundërshtari është i fortë. Është një ekip me fizik të lartë dhe me ritëm të shpejtë, pasi luan futboll të stilit anglez, por ne jemi përgatitur mirë për këtë lojë dhe i kemi bërë zgjidhjet e duhura se s'i t'i kundërvihemi. Ne shkojmë atje me vetëbesim të lartë dhe duam t'i marrim tri pikë të tjera ndaj tyre ashtu siç i kemi marrë para tifozëve tanë", ka thënë Fazliji. "Atmosfera gjithmonë është e mirë në Përfaqësuese. Është krenari të luash për kombin tënd. Jashtë stërvitjes kemi atmosferë shumë të mirë dhe harmoni ndërmjet vete, ndërsa në stërvitje punojmë të disiplinuar dhe e japim maksimumin. Besoj se jemi përgatitur mirë, pasi kushtet kanë qenë shumë të mira", ka shtuar Fazliji.



I ftuar për herë të parë në Përfaqësuesen e Kosovës është edhe futbollisti i Ballkanit, Lindon Emërllahu. Ky i fundit është shumë i lumtur që është pjesë e "dardanëve" dhe uron që në të ardhmen të ketë edhe më shumë futbollistë nga Superliga e Kosovës që ftohen në përfaqësuese. "Ftesa e Giresses ka qenë e pabesueshme për mua. Të jesh pjesë e Përfaqësueses është ndjenjë e papërshkrueshme. Shpresoj që edhe futbollistë të tjerë të Superligës në të ardhmen të marrin ftesa nga Përfaqësuesja dhe ta përjetojnë këtë ndjenjë. Ekipi më ka pritur shumë mirë. Është, thjesht, një ndjenjë e papërshkrueshme. Secili prej lojtarëve më është afruar, më ka përkrahur dhe më ka pritur jashtëzakonisht mirë. Gjatë këtyre ditëve jemi përgatitur mjaft mirë. Atmosfera është shumë e mirë në grup, si jashtë fushës, ashtu edhe brenda fushës, dhe shpresoj në rezultat pozitiv", ka thënë Emërllahu.

# Peja - Ylli, deri i Superligës

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Xhiroja e tretë në Prince Caffe Superligën e Kosovës në basketboll do të dhurojë ndeshje interesante. Takimi hapës i xhiros është në mes të Rahovecit dhe Trepçës që zhvillohet të premten. Vreshtarët kanë një fitore e një humbje, kurse mitrovicasit kanë dy fitore dhe synojnë të tretën me radhë. Kjo është edhe një sfidë për mitrovicasit para kualifikimeve në FIBA Europe Cup.
Të shtunën zhvillohet ndeshja ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Vëllaznimit. Të dyja skuadrat kanë nga një fitore e një humbje dhe synojnë fitoren e dytë në këtë edicion. Përballja kryesore zhvillohet në "Karagaçi" ndërmjet Pejës dhe Golden Eagle Yllit. Pejanët janë kampionë të Ligës Unike, kurse therandasit kampionë të Kosovës. Peja ka dy fitore në këtë edicion, kurse Ylli dy humbje. Takimi pritet të jetë mjaft interesant, siç ka ndodhur në takimet e fundit mes tyre. Ndeshja e fundit e kësaj xhiroje është derbi i Prizrenit në mes të Bashkimit dhe Ponte Prizrenit. Bashkimi ka një fitore e një humbje, kurse Ponte dy humbje në dy ndeshjet e para.

**SUPERLIGA - Java 3**

**Të martën takohen:**
19:00 Rahoveci - Trepça

**Të shtunën takohen:**
17:00 Sigal Prishtina – Vëllaznimi

**Të dielën takohen:**
17:00 Peja - Golden Eagle Ylli
19:00 Bashkimi - Ponte Prizreni



# Driton Kuka nderohet me titullin 'Honoris Causa'

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Trajner i njohur i xhudos Driton Kuka është nderuar me titullin "Honoris Causa" nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për kontributin e dhënë në sport dhe njohjen e Kosovës.
Rektori i UP-së, Naser Sahiti, tha se me punën e trajnerit Kuka është lartësuar Kosova. Sahiti ka thënë se Kuka i ka thyer shumë barriera. "Jam lumtur t'i uroj mirëseardhje Driton Kukës, i cili me punën e tij ka lartësuar vendin tonë kudo në botë. Si universitet me traditë sot po shënojmë ceremoninë e doktoratës së nderit të 21-të me radhë, në shekullin 21, i cili mbahet për Driton Kuka, trajner dhe selektor i Përfaqësueses së Kosovës në Xhudo, i cili për më shumë se një dekadë ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e sportit", ka thënë ai.



Ai theksoi se Driton Kuka është pikë referimi për shumë të rinj. "Figura e tij është pikë referimi për shumë të rinj. Kuka së bashku me medalistët që ka përgatitur ka thyer shumë barriera dhe i ka treguar botës se në vendin tonë, Kosovë, shihet pasuria më e madhe - rinia jonë e talentuar", ka thënë Sahiti.
E në fjalën e tij, profesori universitar Hasim Rushiti tha se trajneri Driton Kuka në fushën e sportit në arenën ndërkombëtare është i jashtëzakonshëm. "Jam jashtëzakonisht i nderuar që sot ta paraqes arsyetimin e iniciuar nga Fakulteti Fizik dhe i Sportit i mbështetur edhe nga UP-ja që t'i ndahet çmimi 'Doctor Honoris Causa' Driton Kukës". "Kontributi i trajnerit Kuka në fushën e sportit si dhe në njohjen dhe afirmimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare është e jashtëzakonshme. Rrugëtimin e punës së palodhshme profesionale e kurorëzoi me arritjet e rezultateve në nivelet më të larta botërore", ka thënë Rushiti.

## Broja: Luajmë për tri pikë ndaj Izraelit

DURRËS, 22 SHTATOR - Kombëtarja shqiptare vijon përgatitjet intensive në kompleksin në Durrës para përballjes të shtunën me Izraelin, me fillim nga ora 20:45. Sulmuesi shqiptar, Armando Broja, theksoi në fjalën e tij se ekipi do të udhëtojë drejt Izraelit vetëm me një qëllim: për t'i marrë tre pikët. "Këto dy ndeshje janë shumë të rëndësishme. Duhet fitore dhe tri pikë për secilën nga ndeshjet dhe trajneri është ai që bën formacionin. Në stërvitje kemi përgatitur disa skema për ta fituar ndeshjen. Vetëm fitoren e kemi në mendje dhe uroj që t'i marrim tri pikë", ka thënë Broja. "E dimë që do të jetë ndeshje e vështirë sepse na ka mundur në ndeshjen e parë, por këtë herë na duhet fitorja dhe uroj të luajmë mirë si ekip dhe të fitojmë", ka shtuar Broja.



## Ronaldo mund të rikthehet në Itali, e kërkon Udinese

Udinese, 22 shtator - Ylli portugez Cristiano Ronaldo është ftuar t'i bashkohet klubit italian Udinese Calcio pasi sulmuesi 37-vjeçar ka kaluar pjesën më të madhe të verës duke u përpjekur që të largohet nga skuadra Manchester United, shkruan "Goal". Ai është i etur për të gjetur një rrugëdalje nga "Old Trafford" gjatë dritares së fundit, pasi qëllimi i tij ishte të jetë pjesë e Ligës së Kampionëve dhe në garë për fitore të mëdha. Tani ish-ylli të Juventusit i është kërkuar ta shqyrtojë një kthim në Itali duke iu bashkuar skuadrës Udinese.



# 'Minatori', arenë e Superkupës Mbarëkombëtare

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Është nënshkruar edhe zyrtarisht marrëveshja ndërmjet Ligës Unike dhe KB Trepçës për organizimin e Superkupës Mbarëkombëtare. Kjo ngjarje do të mbahet më 5-6 tetor në palestrën "Minatori" të Mitrovicës, ku do të marrin pjesë kampioni i Kosovës, Golden Eagle Ylli, fituesja e Kupës së Kosovës, Trepça, kampiona e Shqipërisë, Teuta e Durrësit dhe fituesja e Kupës së Shqipërisë, Tirana. Marrëveshjen e kanë nënshkruar Elvira Dushku, anëtare e Bordit Drejtuesit të Ligës Unike dhe Përfaqësuesi i KB Trepçës, Edin Vërbiqi. Dushku është shprehur se pret spektakël të basketbollit për dy ditë me radhë në Mitrovicë. "Në Superkupën Mbarëkombëtare marrin pjesë katër skuadra shumë të mira dhe presim spektakël të basketbollit për dy ditë me radhë jo vetëm sa iu përket ndeshjeve, por edhe organizimit. Besoj se do të jetë një organizim madhështor, që nuk e kemi parë deri më tani. Stafi i Ligës Unike dhe Federatës së Basketbollit të Kosovës do të ndihmoj që kjo ngjarje të kalojë në nivelin më të lartë dhe të jetë shembull për organizimet e ardhshme", është shprehur Dushku për faqen zyrtare të Ligës Unike.




Në anën tjetër, Vërbiqi ka folur për organizimin që do të jetë në Mitrovicë. "Për ne është krenari që Superkupa Mbarëkombëtare do të organizohet në qytetin tonë. Interesimi është shumë i madh, andaj presim që palestra të jetë e mbushur për dy ditë. Jemi të nderuar që organizojmë Superkupën, ku marrin pjesë fituesit e trofeve të Kosovës dhe Shqipërisë. Do të mundohemi ta organizojmë në mënyrën më të mirë të mundshme, ndërsa detajet e tjera do t'i shpalosim më vonë", ka thënë përfaqësuesi i Trepçës. Superkupën Mbarëkombëtare edicionin e kaluar e kishte fituar Golden Eagle Ylli.

# Federeri: Po pensionohem, por nuk do të largohem nga sporti

LONDËR, 22 SHTATOR - Nga Londra, ku po përgatitet për turneun e Laver Cup dhe ku do ta zhvillojë ndeshjen e lamtumirës, tenisti zviceran Roger Federer ka folur për herë të parë për mediet për vendimin e marrë. Ai konfirmoi se në këtë turne do të luajë vetëm një ndeshje, atë të lojës dyshe me Rafael Nadalin ditën e premte. "Vendimin për t'u tërhequr e mora pas përfundimit të Wimbledonit. Rikuperimi i gjurit nuk po ecte ashtu si duhet dhe e pyeta veten se çfarë kuptimi ka të vazhdoj kështu? Më dukej vetja sikur ecja në akull, që mund të thuhej në çdo moment. Mendoj se ky është vendimi i duhur dhe i vetmi", ka thënë Federeri. "Tani që mora vendimin jam më i qetë se para se ta bëj publike lamtumirën. Prindërit e mi, bashkëshortja, e vuajtën po aq sa edhe unë. Por tani jam i qetë. Jam në Londër për Laver



Cup dhe ndihem mirë, të paktën në stërvitje. Do të luajmë vetëm lojën dyshe të premten dhe do t'i lëmë vendin Berrettini", ka shtuar Federeri. "Shpresoj që gjuri ta mbajë për lojën dyshe. Edhe pse e kam ulur ritmin e stërvitjes, kam qenë në formë për këtë turne. Dua të vazhdoj të realizoj ndeshje 'show'. Nuk do të largohem nga sporti. Dua të jam i përfshirë edhe pse nuk e di ende se si", ka deklaruar Federeri.

## SHKURT

### Broja përfundon në listën e Milanit

Zlatan Ibrahimoviqi nga sezoni i ardhshëm me shumë mundësi nuk do të jetë pjesë e Milanit për shkak të moshës dhe dëmtimeve. Mes emrave për ta zëvendësuar prej javësh qarkullojnë Hajlund dhe Kudus. Gjithsesi "Corriere dello Sport" konfirmon se një objektiv i madh është Armando Broja. Sulmuesi kuqezi është kërkuar me ngulm në muajt e fundit nga Napoli, por në fund vendosi të qëndronte te Chelsea. Blutë e Londrës për ta lënë të lirë kërkojnë plot 35 milionë euro, teksa së fundmi kanë rinovuar kontratën me bomberin 21-vjeçar edhe për disa vjet të tjera.

### Ferrari dorëzohet: Verstappeni e meriton titullin

Pak për meritë të Red Bullit dhe pak për shkak të gabimeve të vetë skuadrës, te Ferrari pranojnë se ky sezon është i pilotit holandez Max Verstappen, që ka fituar 11 nga 16 garat e zhvilluara deri më tani. I shkëputur ndjeshëm nga rivalët, piloti holandez pret ta festojë titullin e dytë kampion në Formula 1. Ai që pranon këtë dominim është spanjolli i "kokëkuqes" Carlos Sainz që, para garës së Singaporit, ka thënë: "Mendoj se Max po zhvillon një sezon të mirë. Ka bërë shumë pak gabime. Edhe aty ku ka gabuar, ka rikuperuar dhe ka fituar". "Mendoj se kjo ka bërë diferencën këtë sezon, që ka ditur të fitojë edhe kur ka qenë në vështirësi. Më përjashtim të tri garave të para, pjesa tjetër e sezonit ka qenë e shkëlqyer për Max dhe e meriton të shpallet kampion bote", u shpreh Sainz.

### Dembele: Nuk kam menduar kurrë të largohem nga Barça

Sulmuesi i Barcelonës, Ousmane Dembele, ka konfirmuar se asnjëherë nuk e ka menduar largimin nga "Camp Nou". "Unë kam qenë te Barça për gjashtë vjet, kam dashur të qëndroj dhe gjithmonë i kam thënë Xavit. Pastaj janë negociatat, por kurrë nuk kam menduar të largohem nga klubi. Më kujtohet një takim me Xavin në dhjetor, ku i thashë se do ta firmosja kontratën. Më pas ndodhi ajo që ndodhi, por gjithmonë kam thënë se dua të qëndroj në Barcelonë", ka thënë futbollisti francez, i cili në Barcelonë u transferua nga Borussia Dortmundi.

### Juve kontakton Conten

Në Angli nuk kanë dyshime se mungesa e rinovimit të Antonio Contes me Tottenhamin është e lidhur me mundësinë e një rikthimi të mundshëm te Juventusi. Sipas asaj që raporton "Daily Mail", Pavel Nedved, zëvendëspresident i bardhezinjve, ka nisur punën për ta bindur mikun e tij, Conte, për mundësinë e një rikthimi të mundshëm në verën e ardhshme. Max Allegri për momentin është në dyshim të madh për ta vijuar aventurën me klubin torinez, por edhe nëse shkarkohet, vendin e tij pritet ta zë Montero, një ish-lojtar aktualisht i punësuar tek ekipi i të rinjve. Pas mbledhjes së të premtes te klubi torinez, sipas medieve italiane, mund të ketë më shumë qartësi për të ardhmen.

## Trajneri i Belgjikës: Është rasti i fundit për të fituar diçka me këtë brez fenomenesh

Belgjika ka vite që qëndron në krye të ranglistës së shtëpisë më të madhe të futbollit botëror FIFA. Emra të mëdhenj luajnë për këtë kombëtare, por pa arritur të fitojnë diçka të rëndësishme. Trajneri Roberto Martinez është i vetëdijshëm për lojtarët që ka në radhët e veta, por thotë se është rasti i fundit të fitojnë diçka të rëndësishme. "Do të luajmë edhe tri ndeshje përpara nisjes së Kupës së Botës, kështu që do ta marrim informacionin që na nevojitet në lidhje me gjendjen dhe formën tonë. Kemi disa lojtarë të cilët, kur janë në formë, janë gjithmonë aty për ta bërë dallimin. Është rasti ynë i fundit për të fituar diçka. Ne kemi një grup historik të rëndësishëm, shumë kampionë, një brez fenomenesh që na kanë bërë të jemi numri një në renditjen e FIFA-s, por nuk kemi fituar asgjë. Është një nga shanset e fundit që kemi", ka thënë Martinezi.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*
***MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË***
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**
***AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE***
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

Numër: 1378/1
Datë: 22.09.2022

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës se Kosovës nr. 7/26 Mars),në bazë të Ligjit Nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës te dt. 09.09.2022 me nr. 1974 së **QK"Shtjefën Gjeçovi" - Prishtinë** shpall:

## Ftesë për ofertë

***Për ekskursion të maturantëve të QK"Shtjefën Gjeçovi" - Prishtinë, në Republikën e Shqipërisë***

***Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.***

***Agjensioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:***

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet te ketë dokumetacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjensioni duhet të ketë një dëshmi për marreveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit **( KDSH ka preferuar javën e fundit të muajit tetor me datë 05,06,07,08,09.10.2022-katër netë).**
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskusionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2020-2021-2022)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e uleseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuara!

***Kushtet tjera:***

- *Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,*
- *Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në eskursion,*
- *Hoteli të posedojë sallë për ballo,*
- *Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike*
- *Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),*
- *Mundësi vizite në qytetet: Tiranë , Krujë, Berat, Vlorë etj.*

***Vlerësimi i ofertave:***
Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.
Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi ofertues
- Lloji i Hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve
- Referencat

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfituesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje te shkollës.

